



SHERBIMI SOCIAL

#REFORMA E VLERËSIMIT BIO-PSIKOSOCIAL



Gjatë muajit korrik u zhvillua takimi me 150 punonjës të komisioneve të vlerësimit bio-psiko-social.

Në këtë takim u ritheksua rëndësia e përkushtimit ndaj detyrës së çdo punonjësi në shërbimin ndaj qytetarëve.

Takimi u organizua në formatin e një trajnimi për rifreskimin e njohurive, sqarimin e situatave të reja me të cilat përballen çdo ditë.

#MOSHIMI AKTIV

Në kuadër të përpjekjeve për moshimin aktiv u mbajt një tryezë diskutimi mbi shërbimet e integruara për moshën e tretë.

Në takim u prezantua përvoja e Njësisë Administrative Sukth mbi ngritjen e regjistrit elektronik të moshës së tretë, sfidat dhe metodologjinë e ndjekur.





SHERBIMI SOCIAL

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajt korrik 2023 janë mbledhur komisionet për sistemimin në institucionet e përkujdesit shoqëror, ku janë sistemuar 2 fëmijë, 4 të moshuar si edhe 16 transferime mbrenda institucioneve të përkujdesit.

Janë rinovuar 60 statuse të jetimit si dhe janë trajtuar 5 raste emergjente fëmijësh.

Po punohet në vazhdimësi për hartëzimin e shërbimeve sociale në Shqipëri, ku aktualisht është përfunduar procesi i rishikimit të draftit të parë të hartës së shërbimeve.



#PUSHIMET VERORE NË IPSH

Përfituesit e shërbimeve shoqërore në institucionet në varësi të Shërbimit Social Shtetëror po shijojnë ditë të freskëta në bregdetin tonë, në ambientet e shtëpisë sonë të pushimit në Velipojë dhe Palasë.

